



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE  
Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obaveštajna Jedinica  
Financial Intelligence Unit  
Nr./Br. FIUAD: 214/2023 Nr.faq./br.str. -1-  
Data/Datum 19/10/2023  
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT

Datë: 19/10/2023  
FIUAD: 214/2023

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Njesisë për Inteligjencë Financiare në pajtim me kompetencat e dhëna sipas nën-paragrafit 1.11 të paragrafit 11 të nenit 14, dhe nenit 66 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, me qëllim të zbatimit të paragrafi 6 të nenit 18 të këtij Ligji për dhënien e efektit në zbatim të listës së juridiksioneve me rrezikshmëri të lartë dhe atyre nën monitorim të publikuar nga FATF nxjerr këtë:

**Udhëzim**

**për masat ndaj juridiksioneve me rrezikshmëri të lartë dhe atyre nën monitorim të shtuar**

1. FATF identifikon dhe rishikon vazhdimisht juridiksionet me mangësi strategjike në fushën e PPP/LFT që paraqesin rrezik për sistemin financiar ndërkombëtar dhe monitoron nga afër progresin e tyre. Grupi i Rishikimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të FATF-së (ICRG) është përgjegjës dhe mbikëqyr këtë proces. FATF shqyrton juridiksionet bazuar në kërcënimet, dobësitë ose rreziqet e veçanta që rrjedhin nga juridiksioni. NjIF-K bazuar në listën e juridiksioneve me rrezikshmëri të lartë dhe atyre nën monitorim të publikuar nga FATF udhëzon si në vijim:
  - A. Të gjitha subjektet raportuese duhet të zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT që janë efektive dhe në proporcion me rreziqet e identifikuara për marrëdhëniet dhe transaksionet e biznesit me personat fizik dhe juridik që ndërlidhen me juridiksionet e listuara nga FATF.
  - B. Publikimi i listës së FATF bëhet në web faqen e NjIF-K [www.fiu.ks-gov.net](http://www.fiu.ks-gov.net), si dhe NjIF-K do të bëjë përditësimin e kësaj liste në baza periodike dhe në harmoni me përditësimet e bëra nga FATF-së.
  - C. Mosrespektimi i këtij udhëzimi paraqet shkelje administrative sipas përcaktohet në paragrafin 1.7 të nenin 43 të Ligjit për PPP/LFT.
  - D. Ky udhëzim shfuqizon Udhëzuesin FIUAD 70/2018 të datës 08/05/2018.
  - E. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në ndryshimin e ardhshëm nga NjIF-K.

Behar XHEMA

UD - Drejtori - Njësia për Inteligjencë Financiare e Kosovës

